

## **RAPORTIM PËR ZBATIMIN E**

### **LIGJIT NR. 119/2014 “PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT”**

**&**

### **LIGJIT NR. 146/2014 “PER NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK”**

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në cilësinë e autoritetit publik, subjekt i ligjit nr. 117/2014 “Për të drejtën e informimit”, ka përmbushur detyrimet ligjore, si më poshtë:

#### **1. Programi i Transparencës**

Në zbatim të **neni 4** “Përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencës”, i cili parashikon se çdo autoritet publik duhet të miratojë dhe të zbatojë një program institucional të transparencës, nga ana MZHETTS është miratuar dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit “Programi i Transparencës i MZHETTS”, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë program janë përfshirë, kategoritë

[http://www.ekonomia.gov.al/files/userfiles/PROGRAMI\\_I\\_TRANSPARENCES.pdf](http://www.ekonomia.gov.al/files/userfiles/PROGRAMI_I_TRANSPARENCES.pdf)

#### **2. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve**

MZHETTS, në përputhje me standardet e vendosura nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për formatin dhe përmbajtjen, ka publikuar në website zyrtar Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.

#### **3. Caktimi i Koordinatorit për të Drejtën e Informimit**

MZHETTS, duke vënë në dijeni edhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka caktuar koordinatorin për të Drejtën e Informimit.

Të dhënat e kontaktit të nëpunësit civil, të caktuar si koordinator, janë publikuar në ëbsite zyrtar të ministrisë.

#### **4. Caktimi i Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik**

MZHETTS, duke vënë në dijeni edhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka caktuar koordinatorin për të Njoftimin dhe Konsultimin Publik (data 20.05.2016).

#### **5. Konsultimi i projekt akteve në zbatim të ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”**

- *Procesi konsultativ për ligjin e Turizmit*

Për rishikimin e legjislacionit në fushën e turizmit u ngrit Grupi i Punës në Ministri, i cili evidentoi problematikat e dala nga ligji ekzistues, si dhe ato të paraqitura nga grupet e interesit. Gjatë periudhës Tetor 2013 - Shkurt 2014, u organizuan një sërë takimesh me Autoritetet Kombëtare e Vendore, përfaqësues të grupeve të interesit dhe shoqërisë civile.

Konkretisht, janë organizuar takimet si më poshtë:

1. Takim me autoritetet vendore, përfaqësues të grupeve të interesit dhe shoqërisë civile në qytetin e Korçës, më datë 20.12.2013;

2. Takim me autoritetet vendore, përfaqësues të grupeve të interesit dhe shoqërisë civile në qytetin e Tiranës, më datë 16.01.2014;

3. Takim me autoritetet vendore, përfaqësues të grupeve të interesit dhe shoqërisë civile në qytetin e Shkodrës, më datë 17.01.2014;

4. Takim me autoritetet Vendore, përfaqësues të grupeve të interesit dhe shoqërisë civile në qytetin e Durrësit, më datë 24.01.2014;

5. Autoritetet Vendore, përfaqësues të grupeve të interesit dhe shoqërisë civile në qytetin e Elbasanit, më datë 27.02.2014;

6. Autoritetet Vendore, përfaqësues të grupeve të interesit dhe shoqërisë civile në qytetin e Gjirokastrës, më datë 03.03.2014.

Drafti i projektligjit të ri “Për turizmin” iu dërgua për mendim, gjatë muajit shkurt 2014, grupeve të interesit.

Janë reflektuar në projektligj komentet dhe sugjerimet e ardhura nga sektori privat, shoqëria civile dhe aktorë të tjerë në sektorin e turizmit, pjesë e Komitetit Këshillimor të Turizmit.

Anëtarët e KKSPT:

- Enver Mehmeti - Presidenti i Shoqatës së Turizmit Shqiptar
- Matilda Naço - Drejtore Ekzekutive e Shoqatës së Turizmit Shqiptar
- Sadik Malaj - Përfaqësues i UNIONIT Turistik
- Ismail Beka - GIZ Abania
- Edlira Muhedini - USAID
- Sonia Popa - Drejtor e Përgjithshme e Zhvillimit të Turizmit
- Orieta Glozheni - DMO Korçë - Drejtor Ekzekutiv
- Kliton Gerxhani - Agjenci Turistike
- Alket Islami – President i Aeronautikës Shqiptare
- Fatos Baxhaku - Gazetar
- Vjollca Bakiu - Akademike
- Besnik Vathi - Agjenci Turistike
- Klodiana Gorica - Akademike

Gjithashtu, janë marrë në konsideratë, komentet e bëra nga institucionet e varësisë, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e turizmit.

Grupi i punës, është asistuar nga USAID, nëpërmjet projektit “Rritje Albania”.

Organizata Botërore e Turizmit, dërgoi komentet, opinionet dhe sugjerimet e saj lidhur me draftin e projektligjit të turizmit.

Janë marrë në konsideratë përvojat pozitive të legjislacionit dhe praktikave administrative të disa shteteve anëtare të BE-së, si Malta, Kroacia etj.

Qëllimi kryesor i projektligjit “Për Turizmin” është përcaktimi i parimeve dhe i rregullave që veprojnë në fushën e turizmit, si dhe përpunimi dhe aplikimi i standardeve kombëtare në industrinë e turizmit ( Hoteleri, Agjencitë turistike, Shtëpitë Pritëse ).

Drafti i parë i projektligjit kaloi për mendim në grupet e interesit, si dhe u shqyrtua në takimet e Komitetit Këshillimor të Sektorit Privat të Turizmit, si një fazë paraprake e hartimit të një drafti ligjor të përmirësuar.

Në raundin e dytë projektligji se bashku me relacionin shpjegues u dërgua për mendim ministrive të linjës.

Ky projektligj është miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 317 datë 28.05.2014. Pas miratimit u dërgua në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, por u tërhoq më pas nga Këshilli i

Ministrave. Tërheqja e këtij projektligji, u bë për arsyen e harmonizimit të kapitullit të investimeve me projektligjin për investimet strategjike dhe partneritetin publik privat.

Referuar projektligjit, së bashku me relacionin shpjegues, iu dërgua për mendim ministrive të linjës.

Për ligjin e ri të Turizmit, në Komisionin e Ligjeve dhe Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, diskutimet zgjatën, fund Qershori - fund Korriku 2015 dhe morën pjesë dhe grupet e interesit. Gjithashtu janë organizuar takime ndërmjet grupit të punës dhe anëtarëve të Komisionit të Veprimtarive Prodhuese dhe juristëve.

- ***Procesi konsultativ për ligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, i ndryshuar***

Projektligji është hartuar nga Ministria, në bashkëpunim me Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve. Për përgatitjen e këtij ligji janë zhvilluar një sërë konsultimesh dhe takimesh, ku janë përfshirë përfaqësues nga të gjithë institucionet qendrore dhe nga organizata të ndryshme, të cilat kanë dhënë kontributin e tyre, si: SIGMA, USAID, Tetra Tech ARD & IFC. Komunikimi me institucionet ka qenë i vazhdueshëm dhe për një periudhë të gjatë kohe, me qëllim hartimin e ndryshimeve ligjore në përputhje me nevojat ekonomike të vendit dhe direktivën përkatëse.

- ***Procesi konsultativ për ligjin “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”,***

Për hartimin e këtij projekt-ligji u ngrit një grup pune me përbërje: MZHETTS, AIDA dhe Këshilli i Ministrave, i cili erdhi si një rezultat i një analize për përmirësimin e dy elementëve bazë, të cilët kanë qenë problematikë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në tërheqjen e investimeve të huaja. Thjeshtimi i procedurave zvarritëse ishte gjithashtu një nga elementet që duheshin përmirësuar.

Projekt ligji është konsultuar në mënyrë të vazhdueshme me IFC, në disa faza të tij që në momentin e konceptimit dhe deri në fazën e fundit para miratimit në KM.

Me qëllim realizimin e një procesi konsultativ sa më gjithëpërfshirës, projektligji është prezantuar në reforma për investimet strategjike në Këshillin Ekonomik Kombëtar (KEK).

Gjithashtu, ky ligj është prezantuar dhe diskutuar në mbledhjen e Këshillit të Investimeve me partnerët ndërkombëtarë si dhe me komunitetin e biznesit.

Aktet nënligjore në zbatim të ligjit, janë hartuar në bashkëpunim me studion ligjore HM&M, e kontraktuar në kuadër të Programit “PROINVEST” GIZ, i cili i dedikohet qeverisjes së mire, për përmirësimin e klimës së investimeve në vendin tonë.

Partnerë kryesorë që përfitojnë nga ky program janë, MZHETTS, AIDA dhe Zyra e Kryeministrit, si dhe ministritë e linjës që lidhen me Politikën e Nxitjes së Investimeve.

Kjo asistencë teknike po zbatohet në veçanti, për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit të Investimeve Strategjike.

- **MZHETTS ka publikuar së fundmi për njoftim dhe konsultim publik Draft-Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, në faqen zyrtare të internetit.**

[http://www.ekonomia.gov.al/files/userfiles/Njoftimi\\_konsultimit-2.pdf](http://www.ekonomia.gov.al/files/userfiles/Njoftimi_konsultimit-2.pdf)